



REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVA – URED PREDSEDNIKA

DEKRET PËR RATIFIKIM TË MARRËVESHJES
NDËRKOMBËTARE

Duke u bazuar në nenin 18, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 4, pika 3 të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik,

D e k r e t o j

Ratifikimin e Marrëveshjes në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë për Transportin Rrugor Ndërkombëtar të Udhëtarëve dhe Mallrave, të nënshkruar me datë 20 maj 2010, dhe të pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës me datë 26 maj 2010.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e ratifikuar hynë në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Nr. i Dekretit: DMN-017-2010

Prishtinë, më 28 maj 2010

Dr. Fatmir Sejdiu
President i Republikës së Kosovës



Njësia Org Org. Unit	02	Nr. i Prot. Prot. No.	1373
Nr. i faqes No. Pages	10	Ç. 014 Date	25-05-10 / 20

**MARRËVESHJE MES QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
 SË TURQISË NË TRANSPORTIN RRUGOR NDËRKOMBËTAR TË UDHËTARËVE DHE
 MALLRAVE**

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Turqisë,

Me dëshirën për të kontribuar në zhvillimin e marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike midis dy vendeve si dhe zhvillimit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve midis dy vendeve, për dhe nga vendet e treta si dhe transitit përmes territoreve të tyre në kuadër të kornizës së ekonomisë së tregut.

Tani e tutje do t'i referohemi si "Palët Kontraktuese"

Janë dakorduar siç vijon:

**PJESA E PARË
 DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi

1. Dispozitat e kësaj Marrëveshje shërbejnë për transportin rrugor të mallrave dhe udhëtarëve ndërmjet territoreve të palëve kontraktuese, në transit përmes territoreve të tyre, për dhe nga vendet e treta si dhe për automjetet e definuar në nenin 2 të kësaj marrëveshje.
2. Kjo marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese, që rrjedhin prej marrëveshjeve tjera ndërkombëtare.

Neni 2

Përkufizimet

Në këtë Marrëveshje:

1. "Operatori i Transportit" nënkupton çdo person fizik ose juridik i regjistruar në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese, i cili transporton udhëtar ose mallra me qira ose për të tretë ose për llogari të vet në përputhje me ligjet dhe rregullat e caktuara kombëtare që rregullojnë qasjen në profesionin e operatorit të transportit dhe qasjen në treg.
2. "Mjeti" nënkupton:
 - I vetëm ose kombinim i mjeteve, rimorkio apo gjysmë-rimorkio;

- I vetëm ose kombinim i mjeteve i përshkruar më lartë dhe i destinuar për transport rrugor të udhëtarëve ose të mallrave në dispozicion të operatorit të transportit, qoftë në pronësi të tij ose në shfrytëzim me pagesë ose qira.

3. "Regjistrimi" do të thotë vendosja e një numri të identifikimit të mjetit, i cili e identifikon pronarin, karakteristikat teknike dhe targat e regjistrimit të mjeteve nga autoritetet kompetente. Në rast të një kombinimi të mjeteve, mjete motorik është faktori përcaktues për lëshimin ose mos-lëshimin e lejes.
4. "Transporti" nënkupton lëvizjen e mjetit, me ose pa ngarkesë në territorin e vendit të themelimit ose palës kontraktuese.
5. "Kabotazh" nënkupton operacionet e kryera të transportit të udhëtarëve ose mallrave nga një operator i transportit i themeluar në territorin e Palës Kontraktuese mes pikave të ngarkimit dhe shkarkimit të vendosur në territorin e Palës Tjetër Kontraktuese.
6. "Territori i Palës Kontraktuese" nënkupton përkatësisht territorin e Republikës së Turqisë dhe territorin e Republikës së Kosovës.
7. "Transporti për nevoja personale" do të thotë transporti i udhëtarëve dhe mallrave të një ndërmarrje të destinuar vetëm për ose që rrjedh nga veprimtaria e saj ekonomike ose në shërbim të punonjësve të tij/saj, ose që zhvillohet nga organizata jo-profitabile që transporton anëtarët e saj në përputhje me qëllimet e saja sociale; transporti i tillë bëhet pa pagesë, me kushtin që kushtet e tjera të mëposhtme janë të përmbushura..

Automjetet e përdorura për aktivitete të transportit:

- Janë në pronësi të ndërmarrjes ose organizatës me anë të një kontrate qiramarrje.
- Operohen nga një shofer i cili është anëtar i stafit të ndërmarrjes ose organizatës.
- Transporton mallrat të cilat janë pronë e ndërmarrjes ose organizatës ose anëtarëve/stafit të saj.

8. "Transporti Bilateral" nënkupton aktivitetin e transportit të kryer me mjete të ngarkuara ose të zbrazëta të cilat fillojnë në territorin e njëres prej Palëve Kontraktuese dhe përfundon në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Fh



9. "Transporti Transit" nënkupton aktivitetin e transportit të kryera me automjete të regjistruara në njërin prej Palëve Kontraktuese transit përmes territorit të Palës tjetër Kontraktuese pa ngarkim/shkarkim të mallrave si dhe marrje/zbritje të udhëtarëve në territorin e këtij vendi.
10. "Transporti për vendet e Treta" nënkupton aktivitetin e transportit të kryera nga mjetet e regjistruara në njërin prej Palëve Kontraktuese për vendet e treta përmes territorit të Palës tjetër Kontraktuese ose e kundërta.
11. "Vendi i themelimit" nënkupton territorin e Palës Kontraktuese në të cilin është vendosur operatori i Transportit dhe mjete motorik është i regjistruar.
12. "Vendi pritës" nënkupton territorin e palës Kontraktuese në të cilin mjete nuk është i regjistruar dhe nuk është themeluar operatori i transportit.
13. "Autobus" nënkupton mjetet motorike si që janë autobusët, llojet e autobusëve të mesëm dhe mini busëve si dhe mjeteve pa motor me rrota prej gome të tërhequra nga këto dhe të regjistruara në njërin prej Palëve Kontraktuese, dhe janë të dizajnuara dhe të ndërtuara për qëllim të transportimit të më shumë se tetë (8) personave përveç shoferit.
14. "Shërbimi i rregullt i udhëtarëve" nënkupton një shërbim të transportit bilateral dhe transit ku udhëtarët transportohen në itinerare të specifikuar, në pajtueshmëri me orarin dhe për të cilin çmimet dhe tarifat janë vendosur paraprakisht. Udhëtarët hipin ose zbriten në vendndalime të përcaktuara më parë në pajtueshmëri me itinerarin dhe këto shërbime janë të kapshme për të gjithë, përjashtimisht disa rasteve, ku nevojitet rezervimi.

Pavarësisht se kush e organizon shërbimin, termi "shërbim i rregullt i udhëtarëve" përfshin gjithashtu shërbimin i cili transporton kategori specifike të udhëtarëve me përjashtim të kategorive tjera dhe udhëtarëve me këtë rast, dhe ky shërbim plotëson kriteret më lartë. Ky shërbim quhet "shërbim i rregullt i specializuar".
15. "Shërbimi vajtje-ardhje" do të thotë shërbimi ku me anë të udhëtimeve shkuese dhe kthyes në mënyrë të përsëritur, grupe udhëtarësh paraprakisht të formuara transportohen nga vendi i nisjes deri në vendin e destinacionit. Secili grup, që është pjesë e udhëtarëve të cilët kanë udhëtuar në shkuarje, transportohen mbrapa në vendin e nisjes në një udhëtim të mëvonshme. Vendi i nisjes dhe i destinacionit përkatësisht do

FA

Mo

të thotë vendi ku udhëtimi fillon dhe vendi ku udhëtimi përfundon, së bashku me lokacionin që e rrethon përbrenda rrethit prej 50 km.

Udhëtimi i parë në kthim dhe udhëtimi i fundit në shkuarje në një seri të vajtje-ardhjeve zhvillohen të zbrazët.

Përkufizimi i shërbimit vajtje-ardhje nuk është ndikuar nga fakti se disa udhëtarë i bashkëngjiten një grupi tjetër në udhëtimin e tyre në kthim, e as nga fakti se udhëtimi i parë për në pikën e destinacionit dhe udhëtimi i fundit për në fikën e fillimit zhvillohen të zbrazët. Lloji i tillë i shërbimit vajtje ardhje quhet "vajtje-ardhje e rezervuar".

Shërbimi vajtje-ardhje i cili ofron akomodim për së paku 80 për qind të udhëtarëve në destinacion dhe, nëse ka nevojë, gjatë rrugëtimit, me ose pa shujtë, quhet "vajtje-ardhje me akomodim".

16. "Shërbimi i rastit" do të thotë shërbimi që nuk bie as nën përkufizimin e shërbimit të rregullt të udhëtarëve e as nën përkufizimin e shërbimit vajtje-ardhje.

17. "Dokumentet e kontrollit" do të thotë fletudhëtimi për autobusë dhe karroca që veprojnë në përputhje me formën e cila është dakorduar dhe konfirmuar në Komisionin e Përbashkët të referuar në Nenin 15.

PJESA II

TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Neni 3

Shërbimet e rregullta të udhëtarëve

1. Shërbimet e rregullta të udhëtarëve që bëhen me autobus i nënshtrohen sistemit të autorizimit që lëshohen nga autoritetet kompetente në vendin e nisjes dhe destinacionit. Në rast të posedimit të autorizimeve në vendin e nisjes dhe vendin e destinacionit, nuk kërkohet leje tjetër për kryerjen e transportit të rregullt transit përmes territorit të Palëve Kontraktuese.
2. Aplikacioni për autorizim duhet të bëhet nga autoriteti kompetent në vendin e themelimit të operatorit të transportit. Nëse autoriteti aprovon aplikacionin, autorizimi i komunikohet autoritetit kompetent të Palës tjetër Kontraktuese. Nëse nuk ekziston një Marrëveshje bilaterale në mes të operatorit të transportit dhe cilësdo Palë Kontraktuese, autorizimi për shërbimet të rregullta bilaterale mund të refuzohet.

Komisioni i Përbashkët i krijuar në Nenin 15, vendos mbi formën e pranimit të aplikacioneve për autorizime dhe dokumentet mbështetëse të domosdoshme.

3. Autorizimet lëshohen në mënyrë reciproke pas aprovimit nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese.

Fl

By

Vendimi për dhënien ose refuzimin e autorizimit merret brenda një periudhe një mujore përveç nëse ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme.

4. Ndryshimet në kushtet për operim dhe anulimin e shërbimit vendosen sipas rregullave të përcaktuara në nenin 2 dhe 3.

Nëse nuk ekziston më tej ndonjë interes(kërkesë) për operimin e shërbimeve të udhëtarëve, operatori mund të revokon autorizimin duke i njoftuar paraprakisht tri javë më herët autoritetet kompetente të cilat kanë lëshuar autorizimin dhe konsumatorët.

Neni 4

Shërbimet Vajtje- Ardhje

1. Shërbimet vajtje-ardhje të cilat kryhen me autobusë ose karrocë me apo pa akomodim i nënshtrohen sistemit të autorizimeve të lëshuara nga autoriteti kompetent në vendin e nisjes, destinacionit dhe të transitit.
2. Aplikacioni për autorizim do të bëhet në autoritetin kompetent në vendin e themelimit të operatorit të transportit.

Komisioni i Përbashkët i themeluar sipas Nenit 15 vendos mbi formën dhe përmbajtjen e aplikacionit për autorizim, procedurën, numrin e autorizimeve dhe kushtet për aprovim, duke marr parasysh kushtet e marrëveshjes dhe dokumentet mbështetëse të domosdoshme.

3. Komisioni i Përbashkët mund të cakton numër shtesë të autorizimeve, apo të aplikon regjim plotësisht të liberalizuar për shërbimet vajtje-ardhje.

Neni 5

Shërbimet e Rastit

Shërbimet e rastit përjashtohen nga kërkesa e autorizimit dhe duhet të jenë subjekt i dokumenteve të kontrollit. Kushtet për përdorimin dhe përmbajtjen e dokumentit të kontrollit duhet të përcaktohen nga Komisioni i Përbashkët i ngritur sipas Nenit 15.

Neni 6

Dispozita të Përbashkëta të Shërbimeve të Udhëtarëve

1. Autorizimet e transportit janë pronë e operatorit të transportit për te cilat janë lëshuar, nuk mund të përdoren dhe nuk janë të transferueshme te operatorët tjerë të transportit.

2. Zhvillimi i shërbimit të kabotazhës është i ndaluar. Udhëtimet lokale të organizuara vetëm për një grup të udhëtarëve që sjellën paraprakisht në atë lokacion dhe kryhen nga i njëjti operator i transportit me të njëjtën listë të grupit të njëjtë të udhëtarëve pas hyrjes në territorin e palës kontraktuese nuk konsiderohen si shërbime të kabotazhës.
3. Kategoritë vijuese të transportit përjashtohen nga sistemi i autorizimeve:
 - 3.1 Operimet e zbrazëta në transit;
 - 3.2 Mjetet e pa ngarkuara me rastin e hyrjes në territorin e Palës Kontraktuese ose transitimin përmes territorit të tyre nga automjetet e eksportuara përkohësisht apo të përhershme që kanë numër të përkohshëm regjistrimi.
 - 3.3 Transporti i pangarkuar i automjeteve të dëmtuara ose të prishura.
 - 3.4 Mjetet e pa ngarkuara të dërguara që të zëvendësojnë një mjet tjetër, i cili është prishur në një vend tjetër, dhe gjithashtu kthimi i mjetit të pangarkuar, pas riparimit të automjetit të dëmtuar.

PJESA III

TRANSPORTI I MALLRAVE

Neni 7

Sistemi i Lejeve


1. Operatorët e Transportit të themeluar në territorin e Palës Kontraktuese duhet të nënshtrohen sistemit të lejeve në mënyrë që të ndërmarrin:
 - Transport për në/nga vendet e treta dhe operacionet transportuese me rastin e hyrjes së ngarkesave të zbrazëta dhe të mbushura në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.
2. Kabotazhi është i lejuar vetëm me autorizim special të vendit pritës.

Neni 8

Dispozita të përbashkëta për transportin e mallrave

1. Autorizimet e transportit janë pronë e operatorëve të transportit për të cilat autorizimet janë lëshuar, ato nuk mund të transferohen ose përdoren nga ndonjë operator tjetër i transportit.
2. Kur një operator transporti ndryshon doganën e tyre të shkarkimit në dokumentin e deklaratës pas hyrjes në territorin e Palës Kontraktuese dhe vazhdon të bartin mallra të

Fh



cilat nuk janë në shtetësi ende të doganave tjera për shkarkim në territorin e Palës Kontraktuese, ky shërbim nuk duhet të konsiderohet si shërbim Kabotazh.

3. Aktivitetet e transportit bilateral dhe transit, përveç atyre të ngritura nën Nenin 7, janë të përjashtuara (liruara) nga kërkesat e lejeve.

Neni 9

Kushtet e Lejes

1. Autoritetet Kompetente të dy Palëve Kontraktuese duhet të shkëmbejnë një numër të caktuar të lejeve të kërkuara çdo vit.
2. Lejet i lëshohen operatorëve vendor (rezident) të transportit nga autoriteti kompetent ose organi i autorizuar nga autoriteti kompetent.
3. Lejet e lëshuara sipas kësaj Marrëveshje do të përdoren dhe do të jenë të vlefshme për vetëm një (hyrje – dalje) udhëtim përderisa Komisioni i Përbashkët vendos diçka ndryshe.
4. Lejet do të jenë të vlefshme deri më 31 Janar të vitit të ardhshëm kalendarik. Në rast të kombinimit të automjeteve, mjeti motorik është faktor përcaktuar në përdorimin ose përjashtimin e lejes.
5. Komisioni i përbashkët i ngritur sipas nenit 15 vendos për procedurat, formën e aplikimit për autorizim, numrin e lejeve, përmbajtjen dhe kushtet e aprovimit në përputhje me dispozitat e Nenit 7.

PJESA IV

DISPOZITAT E PËRBASHKËTA

Neni 10

Dispozitat e Tatimore

1. Karburanti në rezervuarët normal të automjetit, të cilët janë të ndërtuar nga prodhuesi dhe janë të caktuar për ngasjen e automjetit dhe funksionimin e mjetit motorik, si dhe vajrat dhe pjesët rezervë janë të përjashtuara nga të gjitha taksat e importit në territorin e vendit pritës me kusht që operatori i transportit vepron në përputhje me rregulloret relevante doganore.

2. Transporti që mbulohet me këtë Marrëveshje i nënshtrohet në vendin pritës pagesave rrugore dhe ngarkesave financiare të vëna për shfrytëzimin e rrjetit rrugor ose urave.
3. Vendi pritës mund të mos aplikojë çmime të larta ose vënie të detyrimeve për përdorimin e rrjetit rrugor ose urave për automjetet e Palës tjetër Kontraktuese përveç ato të cilat aplikohen për automjetet në vendin e themelimit në bazë të parimit të reciprocitetit.

Neni 11

Pesha dhe përmasat

1. Pesha maksimale e lejuar, pesha boshtore dhe përmasat e automjetit nuk duhet të tejkalohen nga ato që nuk janë të shënuara në dokumentet e regjistrimit dhe as në kufijtë më të lartë të lejueshmen të cilat janë në fuqi në vendin pritës.
2. Operacionet e transportit të kryera në territorin e Palës Kontraktuese nga automjetet ku pesha dhe përmasat e të cilëve i kalojnë kufijtë maksimal të lejuar, do të aplikohen sanksionet e parapara me legjislacionin vendor të palëve kontraktuese. Pavarësisht, në rastet kur kufizimet e lejueshme të peshës dhe përmasave janë tejkaluar dhe kur ngarkesa është teknikisht e pandashme, atëherë kërkohet autorizim i cili paraprakisht duhet të jepet nga vendi pritës.

Neni 12

Pajisjet dhe karakteristikat e tjera

1. Automjetet që transportojnë mallra që prishen ose mallra të rrezikshme duhet të jenë të pajisura me aparaturë dhe pajisje në përputhje me kriteret e konventave ndërkombëtare përkatëse.
2. Pajisjet e përdorura për monitorim të kohës së ngasjes dhe të pushimit të ekuipazhit të automjeteve duhet të veprojnë në përputhje me dispozitat e konventave ndërkombëtare përkatëse.
3. Palët Kontraktuese marrin përsipër për të promovuar, në kuadër të kësaj Marrëveshje, përdorimin e automjeteve që plotësojnë standardet ndërkombëtare të sigurisë dhe mjedisit.

Neni 13

Kontrolli

Dokumentet e kontrollit të kërkuara për operimet e transportit sipas kësaj Marrëveshje duhet të mbahen në bord të automjetit dhe duhet të paraqiten me kërkesë të zyrtarëve të kontrollit.

Neni 14

Obligimet e operatorëve të transportit dhe ndëshkimet

1. Operatorët e transportit të Palës Kontraktuese kanë për detyrë që në territorin e palës tjetër kontraktuese të veprojnë në përputhje me obligimet që dalin nga marrëveshjet multilaterale në të cilat të dy palët janë Palë Kontraktuese marrëveshjet bilaterale si dhe legjislacionin kombëtar, posaçërisht rregullat e trafikut, marrëveshjet doganore dhe kushtet dhe kufizimet e tjera.
2. Autoritetet kompetente në vendin e themelimit munden, në raste të shkeljeve serioze ose të përsëritura të kryera në territorin e vendit pritës dhe me kërkesë të vendit pritës, të ndërmarr masa administrative në vijim:
 - lëshojnë një paralajmërim,
 - ndalojnë qasjen në territorin e Palës Kontraktuese ku është kryer shkelja (et).
3. Në raste të veçanta, autoriteti kompetent i vendit pritës mundet përkohësisht të ndalon qasjen e shkelësit në territorin e tij në pritje të vendimit nga autoriteti në vendin e themelimit.

Palët Kontraktuese do të informojnë njëra tjetrën reciprokisht mbi vendimet e marra.

Neni 15

Bashkëpunimi dhe Komisioni i Përbashkët

1. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të ndërmarrin hapa të nevojshëm për implementimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshje dhe të dërgojnë tek njëri tjetri informacione të dobishme. Autoritetet kompetente gjithashtu do ta mbajnë njëra tjetrën të informuar në mënyrë reciproke për çdo ndryshim në ligjin kombëtar që ndikon zbatimin e kësaj marrëveshje.

Autoritetet kompetente do t'ia mundësojnë njëra tjetrës asistencën reciproke me qëllim të implementimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Komisioni i Përbashkët do të ngritët, i përbërë nga secila Palë Kontraktuese përfaqësuesit e të cilëve janë të emëruar dhe autorizuar që ta implementojn dhe zbatojnë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Komisioni i Përbashkët është përgjegjës për implementimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje si dhe rishikimin, zgjidhjen e të gjitha çështjeve duke përfshirë edhe marrëdhëniet në mes Palëve Kontraktuese në fushën e Transportit Rrugor.

PJESA V

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Autoritetet Kompetente

Duke u bazuar në këtë Marrëveshje autoritetet kompetente do të jenë siç vijojnë:

- Për Republikën e Kosovës – Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit
- Për Republikën e Turqisë – Ministria e Transportit

Neni 17

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje do të hyje në fuqi 30 dite pas marrjes së lajmërimit të dytë përmes kanaleve diplomatike, me anë të së cilave Palët Kontraktuese informojnë njëra tjetrën se kërkesat e procesit të tyre të brendshëm kushtetues, të domosdoshme për hyrje në fuqi të Marrëveshjes, janë përmbyshur.
2. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi përderisa një njoftim me shkrim për anulim (shkëputje) të bëhet nga cilado Palë Kontraktuese. Marrëveshja anulohet gjashtë muaj pas datës së pranimit të njoftimit diplomatik me të cilin Pala Kontraktuese tjetër informohet mbi aktin e anulimit (shkëputjes).
3. E BËRË në dy kopje në Ankara me 20, Maj, 2010 në gjuhën Shqipe, Turke dhe Angleze, secili tekst autentik në mënyrë të barabartë. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje, versioni Anglez duhet të mbizotëroj.

PËR QEVERINË E

REPUBLIKËS SË KOSOVËS



PËR QEVERINË E

REPUBLIKËS SË TURQISË

Binali YILDIRIM

Ministër i Transportit